

Broshura me planet e Serbisë për Kosovën

Tetor 2006

**Decentralizimi => Ndarje
Ndarja => Luftë**

Për Serbinë Kosova fillon përfundi lumit Ibër. Serbia tanimë ka kontroll të plotë në pjesën më të madhe të veriut të Kosovës. Plani i decentralizimit është paraparë të zbatohet në atë pjesë vetëm për të legalizuar pastrimin etnik që vazhdon edhe kësaj dite. Ndërkaq, në pjesët tjera të Kosovës ku ka serbë dhe ku Serbia nuk ka kontroll të plotë, me decentralizim po synohet krijimi i po të njëjtit realitet sikurse mbi lumin Ibër.

Në vitin 2002, UNMIK-u me në krye Michael Steinerin, në kuadër të planit të tij shtatëpikësh për Mitrovicën, e përmendi premtimin për decentralizim bërë serbëve për t'i joshur ata që të marrin pjesë në zgjedhjet e atëhershme lokale. Pas revoltës së 17 dhe 18 marsit të vitit 2004, nën tryshninë e qeverisë së Serbisë, UNMIK-u e bëri decentralizimin prioritetin absolut të agjendës së politikës zyrtare ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë. IPVQ-të si dorë e zgjatur e UNMIK-ut e pranuan këtë gjë pa asnjë vërejtje a kundërshtim. Më 20 korrik 2004, atëbotë Ministër i Shërbimeve Publike, Jakup Krasniqi, së bashku me Drejtorin e Zyres së Çështjeve Politike të UNMIK-ut, rusin Petr Ivantsov, e nënshkruajtën draftin e parë njëzetfaqësh të decentralizimit. Prej UNMIK-ut dhe ish ministrit Krasniqi u kërkua që ky proces të bëhet objektivi fundamental i qeverisë së Kosovës. Drafti iu dërgua kryeministrit të asaj kohe, Bajram Rexhepit. Ai e miratoi draftin, me vetëm një vërejtje: shprehja 'njësitë komunale' të zëvendësohej me 'njësitë e komunave'. Prej atëherë, decentralizimi ka qenë prioriteti absolut i të gjitha qeverive të mëpastajme. Qeveritë janë ndërruar, por përkushtimi i institucioneve për decentralizimin nuk ka prajtur asnjëherë. Kjo i vë në pah dy gjëra. Së pari, qeveria nuk është fare qeveri; dhe së dyti ajo nuk është e

tillë ngaqë në Kosovë udhëheq UNMIK-u me disa kolaboracionistë shqiptarë. Decentralizimin e pat vazhduar qeveria Haradinaj, pastaj Kosumi, kurse sot po e vazhdon ajo me në krye Agim Çekun, gjithnjë me të njëjtin ministër, Lutfi Hazirin.

Sipas planit A të decentralizimit, komunat e reja që parashiheshin të krijoheshin ishin - Graçanica, Parteshi, Mamusha, Hani i Elezit dhe Juniku (shih foton 1). Serbia nuk e pranoi këtë plan. Qeveria e Kosovës pastaj pat vendosur që në vend të Zhegrës (për të cilin fshat partitë politike gjatë fushatës së fundit zgjedhore patën premtuar se do të bëhet komunë) do të jetë Parteshi ai që do të bëhet komunë e re. Dhe, në mënyrë që tek qytetarët të krijohet bindja se decentralizimi nuk po bëhet për serbët, Qeveria e Kosovës qysh në gushtin e vitit 2005 kishte paraparë që përveç Budrigës së Poshtme që është e banuar me serbë, Parteshit t'i bashkohet edhe Cernica, që është e banuar kryesisht me popullatë shqiptare. Gjithsesi, në komunën e re shqiptarët do të ishin pakicë, d.m.th të dominuar nga serbët lokal. Pra, popullata shqiptare e fshatit Cernicë sipas Planit B të decentralizimit parashihej të përfshihej brenda një komune serbe, asaj të Parteshit, në të cilën komunë do të vazhdonin të ekzistonin strukturat paralele serbe dhe formacionet e armatosura të financuara nga shteti i Serbisë. Pra, do të kishte një legalizim të pranisë dhe funksionimit të shtetit të Serbisë në Kosovë. Sipas planit B të decentralizimit (shih foton 2), komuna e Hanit të Elezit, Junikut dhe Mamushës mbeteshin të pandryshuara, kurse përveçqë Parteshit i bashkëngjitej Cernica dhe Budriga e Poshtme, sipas këtij plani Graçanica do ta merrte Hajvalinë si dhe fshatrat Sushicë, Laplasellë dhe Preoc. E gjithë bashkësia ndërkombëtare e pat pranuar planin B të decentralizimit. Por kjo nuk i mjaftoi Serbisë. Ajo e hodhi poshtë edhe këtë plan. Ja, pra pse ai s'u realizua: vetëm pse Serbia s'deshi që ai të realizohej. Serbët e refuzuan Planin B, jo se ai nuk u levërdiste, por për shkak se atë e kishin kurdo, dhe ata donin edhe më shumë se kaq. Kjo është arsyeja pse Serbia pat dalur me planin C për decentralizimin e Kosovës. Plani C nënkuptonte që serbët të jenë jo vetëm shumicë e thjeshtë, por shumicë e theksuar. Sipas këtij plani, Graçanicës iu hoq Hajvalia, kurse iu shtuan fshatërat Badoc i Ri, Shashkoc dhe Çagllavicë. Ndërkaq, Parteshit iu shtua edhe Pasjani (shih foton 3).

Më pas, oferta e Grupit Negociator të Kosovës në negociata me Serbinë ishte shumë e ngjashme me këtë plan të Serbisë. Njëjtë sikur në planin C të

VETËVENDOSJE !

decentralizimit, edhe në ofertën e negociatorëve kosovar, në komunën e Parteshit është përfshirë edhe fshati i madh me përbërje të pastër etnike serbe, Pasjani, që ka 2.160 banorë, për të siguruar kështu lidhje fizike me kufirin e Serbisë përmes fshatit Muçibabë, ku jetojnë jo më shumë se katër familje shqiptare. Sipas ofertës 3+1 të Grupit Negociator të Kosovës, Graçanicës iu shtua edhe Janjeva si dhe fshatrat Uglar, Teqë, Gushtericë e Epërme, Gushtericë e Poshtme, Dobrotin, Livagjë, Konjuh, Suvidoll, Skullanovë e Lepinë (këto 8 të fundit nga komuna e Lypjanit) si dhe Batushë e Dobrevë e Ulët (nga komuna e Fushë Kosovës); Artana u trefishua territorialisht duke ia shtuar disa fshatra nga Dardana e Gjilani. Për herë të parë u propozua që komunë e re të bëhej edhe veriu i Mitrovicës. Përveç kësaj, Parteshit iu shtua edhe Kravarica, Vrapçi, Radivojca, Klllokoti e Mogilla (shih foton 4). Serbia kërkoi edhe më shumë. Grupi Negociator doli me propozimin 4+1. Komunave të propozuara në ofertën 3+1 iu shtu edhe komuna e re e Ranillugut, e banuar 100% me serbë, e cila përfshin fshatërat Rajnoc, Hodec, Drenoc, Ropotovë e Madhe, Ropotovë e Vogël, Domoroc, Kërmjan i Ulët, Kërmjan i Epërm, Glllogoc, Petroc, Paççellë dhe Tomancë (shih foton 5). Serbia nuk u pajtua as me këtë propozim. Grupi Negociator lëshoi edhe më shumë pe. Ai përpiloi ofertën 5+1. Këtë radhë u propozua që të krijohesh edhe një komunë tjetër e re me shumicë serbe, ajo e Klllokotit, e cila do të përfshinte fshatrat Zhiti, Mogillë, Vërboc, Gërncar, Podgorc dhe Letnicë (shih foton 6).

Pra, përveç 5 komunave që aktualisht kontrollohen nga pushteti i Beogradit (Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçani, Novobërda dhe Shtërpca), oferta e fundit e Ekipit Negociator të Kosovës (por, sigurisht, jopërfundimtare, sepse këta njerëz janë të gatshëm t'i ofrojnë Beogradit kontroll edhe në më shumë komuna) parasheh krijimin e 5 komunave tjera: Veriun e Mitrovicës, Graçanicën, Ranillugun, Parteshin dhe Klllokotin, plus trefishimin territorial të komunës së Artanës (ish Novobërdës). Por, plani dhe shënjestra e ardhshme e Serbisë është zgjerimi i veriut të Kosovës në drejtim të veriperëndimit, respektivisht kah Baja, Osojani, Binça dhe Gorazhdeci - vende këto që shtrihen në komunat e Klinës, Burimit (ish Istogut) dhe Pejës (për t'i parë pasojat e deritashme të decentralizimit dhe planet e Serbisë për të ardhmen, shih foton 7).

Ky projekt, pra, nuk është fare decentralizim. Ky është përqendrim i pushtetit të Serbisë në Kosovë dhe konsolidim i entitetit serb brenda vendit tonë. Decentralizimi nënkupton shpërndarjen centrifugale të kompetencave qendrore, pra, zvogëlimin e komunës si territor. E, kjo çka po ndodh në Kosovë është absolutisht e kundërta. Artana po trefishohet territorialisht duke ia bashkëngjitur asaj plot fshatra serbe nga komuna e Dardanës dhe Gjilanit.

Procesi i decentralizimit po shkon sipas planeve serbe për të krijuar një 'zonë sigurie' mes Luginës së Preshevës dhe Kosovës. Pjesët më të rrezikuara do të jenë: Zona kufitare mes Gjilanit dhe Bujanocit, në fakt brezi territorial mes fshatrave Stubllinë dhe Hodanoc (strategjikisht zonë shumë e rëndësishme për lidhjen e vendbanimeve serbe në lindje të Kosovës me Serbinë); Berivojca (fshat i përzier etnikisht afër Dardanës - ku dominimi etnik serb u mundëson serbëve që ta rrethojnë qytetin e dominuar nga shqiptarët - Dardanën; dhe fshatrat Ruboc, Busovatë, Makresh i Poshtëm dhe Kllobokar); Zajçeci (me marrjen e këtij fshati në pjesën veriore të komunës së Dardanës do të vendosej një lidhje territoriale mes Serbisë dhe fshatit të banuar me serbë që quhet Gragjenik).

Në Luginën e Preshevës, në fshatin Boroc të Bujanocit, po ndërtohet një bazë e madhe ushtarake e Ushtrisë Serbe që ka 1.000 shtretër. Ajo do të shërbejë si qendër logjistike dhe komanduese. Qëllimin e kësaj baze e ka shpalosur hapur Nebojsa Çoviqi, ish udhëheqës i Qendrës Koordinuese të Serbisë për Kosovës, i cili me 20 janar 2005 për radion B-92 ka deklaruar se prania e armatës së Serbisë në Luginën e Preshevës është e domosdoshme në mënyrë që serbët nga regjioni i Anamoravës në Kosovë të ndjehen të sigurt. Jorastësisht Serbia po armatohet, ajo po e sofistikon armatimin. Qysh në mesin e vitit 2001 është paralajmëruar ndërtimi i bazës ushtarake të Serbisë në fshatin Borovac, 5 km larg prej Bujanocit, në anën lindore të magjistrales A-10 që çon për në Maqedoni e Greqi. KFOR-i kurrë nuk ka kërkuar ndërprerjen e kësaj pune. Sipas një marrëveshje të ish kryeministrit të Serbisë, Zoran Gjingjiq me ish Ministrin e Mbrojtjes së Rusisë, Serbia do t'i dërgojë qindra tankse T-84 për t'i avansuar në Rusi. Serbia ka porositur 69.200 veshje ushtarake antiplumb dhe 74.000 helmata, me vlerë prej 296 milionë euro - të dyja këto pajisje që rrisin depërtueshmërinë e këmbëtorisë në luftë të armatosur. Përveç kësaj,

VETËVENDOSJE !

aktualisht një sasi të konsiderueshme të armëve automatike M-70 (version jugosllav i kalashnikovit) po i zëvendëson me tipin M-21, e cila posedon edhe dyblinë optike, gjë që e rrit efektivitetin e saktësisë goditëse për 34.3%. Në anën tjetër, gjatë viteve të fundit Shqipëria ka shkatërruar 1.600.000 mina tokësore; 144.000 armë të lehta; 43.000 tonelata me municion dhe 511 tankse dhe automjete të blinduara. Gjithçka e qartë - Serbia po armatohet që të na sulmojë; Shqipëria po çarmatohet që të mos mund të na ndihmojë. Në rast të sulmit që do të na e bënte Serbia, cili shtet do të duhej të na ndihmonte nëse jo Shqipëria.

Në të ardhmen e afërt Kosova dhe veçanërisht komuna e Gjilanit dhe e Dardanës do të kenë sfida të mëdha. Këtë e vërteton edhe vetë Qeveria e Serbisë, nënkryetari i së cilës, Miroljub Labus, qysh me datën 6 nëntor 2004 për gazetën "Politika" ka thënë: "Në kuadër të Kosovës dhe Metohisë do të duhej të formoheshin dy entitete. Entitetin serb do ta përbënin këto zona: Kosova Veriore (komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe veriut të Mitrovicës) dhe Anamorava (komuna e Dardanës, Artana, Graçanica dhe pjesë të Gjilanit dhe Lipjanit)." Në Perëndim Miroljub Labus konsiderohet si i moderuar dhe demokrat. Realizimin e këtij plani të Serbisë në terren e mundëson zinxhiri pothuajse i pandërprerë i fshatrave serbe ndërmjet Ranillugut dhe Artanës, në mes të të cilit gjendet vetëm një fshat shqiptar, Busovata. Ky zinxhir e shkëput komunën e Dardanës, si dhe krijon lidhje me rripin e fshatrave serbe që e lidhin Artanën me Graçanicën. Planin për krijimin e entitetit serb brenda Kosovës, e që do të realizohej pikërisht përmes decentralizimit, e kanë elaboruar në vazhdimësi dhe hapur shumica dërrmuese e zyrtarëve të të gjitha niveleve në Serbi.

Ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941) për shpronësimin e shqiptarëve dhe kolonizimin e Kosovës përdoret Reforma Agrare, ndërkaq sot, për copëtimin e Kosovës përdoret 'reforma e pushtetit lokal'. Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë, i cili nëpërmjet UNMIK-ut u bë edhe projekt i Qeverisë së Kosovës. E filloi qeveria Rexhepi me ministrin e atëhershëm Jakup Krasniqin, e vazhdoi qeveria Haradinaj e pastaj Kosumi me ministrin Lutfi Haziri, kurse sot po e finalizon qeveria Çeku sërish me Lutfi Hazirin, ky i fundit tashmë edhe zëvendëskryeministër. Decentralizimi është mjeti më i efektshëm për zbatimin e planit qeveritar serb për copëtimin e Kosovës. Serbia do që para se ta rimarrë Kosovën, ta

copëtojë atë. Serbia nëpërmjet decentralizimit po synon të bëjë zgjerimin dhe definimin e kufijve të enklavave, krijimin e vazhdimësisë territoriale ndërmjet enklavave nëpërmjet kthimit të planifikuar të serbëve nga qeveria e Serbisë, marrjen e pikave të larta kodrinore e maleve me rëndësi të padiskutueshme strategjike e ushtarake, dhe legjitimimin e strukturave paralele të Serbisë. Meqë nëpër enklava paraprakisht nuk u shpërbënë strukturat e Serbisë në Kosovë, decentralizimi nuk ia ofron pushtetin qytetarëve atje por e dërgon atë në Beograd. Rezultati përfundimtar i realizimit të decentralizimit do të jetë krijimi i kufijve të brendshëm territorial në vendin tonë. Decentralizimi përfundimisht shkakton ndarjen territoriale në Kosovë, duke krijuar entitetin e fuqishëm serb përbrenda Kosovës. Komunitetet e reja serbe përveçse njësi administrative, do të jenë edhe aso territoriale. Duke qenë se me proceset aktuale zyrtare politike në përgjithësi, dhe me këto negociata në veçanti, Kosova vetëm sa përpëlitet si autonomi, decentralizimi do të krijojë shtetin brenda autonomisë. Lufta do të ngjajë gjithësesi, ngase në mos asgjë tjetër, fshatrat shqiptare nuk do të duan të përfundojnë në anën e gabueshme të kufirit - në kuadër të entitetit serb. Fshatarët shqiptar nuk do të pranojnë që shtëpitë dhe arat e tyre të kontrollohen nga strukturat e Serbisë, që policia, gjyqësia, arsimit, shëndetësia dhe administrata e dirigjuar nga Serbia të sundojnë mbi ta.

Fshatrat shqiptare që synojnë t'i fusin në komuna serbe janë mu ato të cilat nuk kishin edhe aq humbje në njerëz e dëme materiale gjatë luftës. Ngaqë, ata besojnë se ato fshatra më lehtë mund t'i përfshijnë në komunitetet e reja serbe. Mirëpo, këtyre fshatrave iu kërcënohet modeli i veriut të Mitrovicës. Në natën ndërmjet 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000, në veriun e Mitrovicës janë vrarë 11 shqiptarë (6 meshkuj e 5 femra). Më pas, gjatë atij muaji janë dëbuar 1.564 familje shqiptare me gjithsej 11.364 anëtarë. Ploja ngjau në prani të forcave të KFOR-it dhe policisë. Në veri kanë mbetur më pak 4.000 banorë shqiptarë. Zyrtarët serbë nga Kosova e Serbia shumë shpesh deklarojnë se si veriu i Kosovës është një vend multietnik. Ja, pra, se çka mendojnë ata kur flasin për multietnicitetin: vendbanime me shumicë dërrmuese të popullatës serbe, të kontrolluara nga strukturat e Serbisë, dhe me shqiptarët që ose janë pakicë, ose dëbohen e vriten që të bëhen të tillë! Në një moment të volitshëm për strukturat paralele të Serbisë, popullata e Cernicës dhe fshatrave tjera shqiptare të shndërruara në enklava rrezikohen ta përjetojnë fatin e shqiptarëve të dëbuar nga veriu i Mitrovicës.

Decentralizimi assesi s'bën të ngjajë para sovranitetit për Kosovën. E pas sovranitetit, nëse dikush ka nevojë për decentralizim, atëherë kjo është Prishtina, lagjet e së cilës për nga numri i banorëve janë më të mëdha sesa shumica e komunave ekzistuese të Kosovës. Vetëm lagjet Kodra e Diellit apo Dardania kanë mbi 100.000 banorë, që është më shumë se numri i banorëve të shumicës dërrmuese të komunave në Kosovë.

Cernica, një fshat më i madh se Parteshi, u dashka t'i bashkohet Parteshit dhe Parteshi të bëhet komunë e re! Sipas ofertës së Grupit Negociator të Kosovës, shqiptarët do të përbënin 45% ndërsa serbët 55% të komunës së Parteshit. Njëherazi, shqiptarët do të gjenden në territoret e kontrolluara drejtpërdrejt nga strukturat paralele militare të financuara dhe të mirëmbajtura nga shteti serb, ndërkaq të toleruara nga UNMIK-u. Në fshatin Cernicë ka multietnicitet, komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, mirëpo pikërisht decentralizimi do ta shkatërrojë këtë duke e sjellur dhe forcuar pushtetin e Beogradit brenda. Nëpërmjet Cernicës, Serbia do të depërtonte deri në periferi të Gjilanit dhe kufiri nuk do të mbetej në luginë (në Partesh), por do të ngjitej më lart në kodër (në Cernicë), gjë që ka shumë rëndësi nga aspekti i kontrollit dhe perspektivës për sulmin ushtarak.

Nga pushtetarët e Kosovës, banorëve të Cernicës që përpiqet ta gllabërojë Serbia, jopublikisht u premtohen fabrika e punësim nëse e pranojnë decentralizimin. Njësoj veprohet edhe me fshatra tjera shqiptare që duan t'i fusin nën komunat e reja serbe. Punësim nën dominim të Serbisë dhe në shkëmbim të pranimit të saj na ofronte edhe Milosheviqi.

Përmes procesit të decentralizimit, i cili enklavave dhe komunave me shumicë serbe po ia mundëson vazhdimësinë territoriale, kjo lidhje horizontale si dhe kontrolli politik i Beogradit mbi këto vendbanime do të jetë shumë i rrezikshëm për të ardhmen e Kosovës. Një arsye më shumë për të qenë të shqetësuar është se Serbia, në ndonjë moment të volitshëm për të, për interesa të saj do t'i përdor serbët lokal për t'i bllokuar shumicën e rrugëve magjistrale në Kosovë. Magjistranja Prishtinë - Prizren dhe ajo Prishtinë - Ferizaj - Shkup do të bllokohej në Çagllavicë; në Graçanicë do të bllokohej magjistranja Prishtinë - Gjilan; në Partesh do të bllokohej

magjistralja Ferizaj - Gjilan; në Ranillug do të bllokohej magjistralja Gjilan - Bujanoc; në Fushë Kosovë do të bllokohej magjistralja Prishtinë - Pejë; magjistralja Mitrovicë - Pejë do të bllokohej në fshatin Bajë; magjistralja Prishtinë - Leposaviq tanimë veç është e bllokuar, prandaj nuk është e mundur lëvizja e lirë e qytetarëve në drejtim të veriut të Kosovës; e vetmja magjistrale e cila do të ishte e lirë për qarkullim do të ishte ajo Prizren - Pejë. Me bllokimin e gjithë këtyre magjistrave, do të pamundësohej lëvizja e qytetarëve nga të gjitha qendrat e Kosovës në drejtim të Prishtinës, kurse qytetarëve të Prishtinës do t'u pamundësohej lëvizja në drejtim të qyteteve tjera brenda apo jashtë Kosovës.

Insitucionet e Kosovës edhe kësaj radhe u ndodhën në anën e kundërt të vullnetit dhe interesave të popullit. Ato jo vetëm që e pranuan decentralizimin por tash po e negociojnë atë me Serbinë në Vjenë. Për rregullimin e brendshëm territorial e administrativ të Kosovës, politikanët negociator kosovar po diskutojnë me Serbinë! Serbia gjithmonë gjente shqiptarë me të cilët zbatonte planet e veta. Vetëm se kësaj radhe ata janë më të shumtë se asnjëherë më parë duke u vetëshpallur përfaqësues të Kosovës. Kohë më parë u bë publik rezultati i peticionit të banorëve të Cernicës kundër decentralizimit. 1294 veta, që paraqesin shumicën në fshat, ngase aty janë 2350 veta me të drejtë vote, nënshkruan peticionin me të cilin ata kundërshtuan decentralizimin dhe futjen e Cernicës në kuadër të komunës së Parteshit. Mbi bazën e vullnetit të këtyre qytetarëve që nënshkruajtën peticionin do të ndërtohet strategjia legjitime e kundërshtimit të decentralizimit me të gjitha format. Me çfarëdo çmimi. Njëjtë do të veprojmë edhe nëpër rastet e tjera të ngjashme nëpër Kosovë në muajt që vijjnë.

Decentralizimi sjell ndarjen, e ndarja luftën. Duke mos e lejuar realizimin e decentralizimit e parandalojmë edhe ndarjen e Kosovës, edhe luftën.

Decentralizimi Plan i A




Foto 1: Plani A i decentralizimit

Decentralizimi Plani B




Foto 2: Plani B i decentralizimit

Decentralizimi Plani C (Propozim serb për Graçanicën dhe Parteshin)




Foto 3: Plani C i decentralizimit

Plani 3+1 (Propozim i parë i GN të Kosovës)




Foto 4: Oferta 3+1 e Grupit Negociator të Kosovës

Plani 4+1 (Propozim i dytë i GN të Kosovës)




Foto 5: Oferta 4+1 e Grupit Negociator të Kosovës

Plani 5+1 (Propozim i tretë i GN të Kosovës)




 Propozimi i GN 5+1 (Grahçanica, Mitrovica e veriut, Parteshi, Klllokoti, Ranillugu dhe zgjerimi i Novobërdës)

Foto 6: Oferta 5+1 e Grupit Negociator të Kosovës

Decentralizimi => Ndarje Ndarja => Luftë





Foto 7: Komunitat ekzistuese të kontrolluara nga Serbia, pasojat e decentralizimit dhe planet e Serbisë për zgjerim në veri-përëndim të Kosovës


Oferta e Grupit Negociator të Kosovës për Anamoravë.




Plani A i decentralizimit për Anamoravë




Plani B i decentralizimit për Anamoravë



Plani C i decentralizimit për Anamoravë



Oferta 3+1 e Grupit Negociator të Kosovës



Oferta 4+1 e Grupit Negociator të Kosovës



Pasojat e përgjithshme të decentralizimit sipas ofertës aktuale por jopërfundimtare të Grupit Negociator të Kosovës në negociatën me Serbinë